VENDIM
Nr. 473, datë 17.7.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 192, DATË 27.3.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT 'PËR ZBATIMIN E MËNYRAVE ALTERNATIVE TË PAGESËS SË SHPEJTË' DHE TË PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E TIJ"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, shkronja "ç", dhe 9/1, të ligjit nr. 25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 192, datë 27.3.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e projektit pilot 'Për zbatimin e mënyrave alternative të pagesës së shpejtë' dhe të procedurave për zbatimin e tij", bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, fjalia e tretë riformulohet, si më poshtë vijon:

"Vlera monetare disbursohet nga Agjencia Shtetërore për Mbështetjen e *Startup*-ve dhe Lehtësuesve ("*Startup Albania*") në formën e një transferte bankare, brenda datës 30 të çdo muaji, në periudhën kohore korrik deri në tetor 2024, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë vendim.".

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Bazuar në parimin e subsidiaritetit, të konsultimit dhe të bashkëpunimit, Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve ("*Startup Albania*") dhe bashkitë, në të cilat do të zbatohet projekti, lidhin një marrëveshje për mënyrën e përzgjedhjes së përfituesve te bashkitë përkatëse. Përzgjedhja duhet të jetë e tillë që të garantojë përbërje të drejtë midis moshës, që përfshin përkatësisht përfitues nga grup-moshat 18–30 vjeç, 30–40 vjeç, 40–50 vjeç, 50–60 vjeç, si dhe 60–70 vjeç, dhe gjinisë së tyre, që banojnë brenda një hapësire gjeografike të afërt brenda territorit të bashkive Tiranë, Dibër e Përmet. Bashkitë përzgjedhin përfituesit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas lidhjes së marrëveshjes. Numri i përfituesve për secilën bashki është 100. Lista emërore me të dhënat e përfituesve për çdo bashki dërgohet pranë Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve ("*Startup Albania*")."

3. Në pikën 12, emërtimi "Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile" zëvendësohet me fjalët "... bashkitë Tiranë (Njësia Administrative 5), Dibër e Përmet ...".

4. Në aneksin A, në paragrafin e dytë të deklaratës, fjalët "..., për periudhën maj, qershor, korrik dhe gusht 2024 ..." zëvendësohen me "..., për periudhën korrik, gusht, shtator, tetor 2024 ...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku